



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 02, datë 29.01.2021

Për miratimin e termave të referencës dhe kritereve të përzgjedhjes së Audituesit të Jashtëm të Specializuar, për auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për vitet financiare 2021 - 2024

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 79, pika 4 të Ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 6, pika 2, shkronja “e”, të nenit 7, pika 6 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6, dhe të nenit 18 pika 2, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, pas konsultimit me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë termat e referencës dhe kriteret e përzgjedhjes së audituesit të jashtëm të specializuar, për auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për vitet financiare 2021 – 2024, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar